

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a., me seli në Prishtinë, rr. “Bill Klinton” pn., kundër debitorit Kid Zone Kosova” sh.p.k., me seli në Prishtinë, Zona Industriale, me pronar F.K., të cilën e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partenrs” sh.p.k., me seli në Prishtinë, përkatësisht B.P., H.H. dhe E.B., avokatë në Prishtinë, sipas autorizimit, lidhur me çështjen përmbarimore, për borxh, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.506/19, i datës 20.05.2019, me datë 20.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike përmbarimore.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Dhomës së Shkallës së Dytë, si gjykatë kompetente në pikëpamje lëndore.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.506/19 të datës 20.05.2019, ka vendosur që të: Pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit Kid Zone Kosova dhe Shfuqizohet Urdhri për lejimin e Përmbarimit P.nr. 410/19 i datës 20.02.2019, i lëshuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat F.B., në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi përfaqësuesi i autorizuar i kreditores brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që: aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe urdhri përmbarimor në tërësi në fuqi.

Në përgjigjen në ankesë, debitori i ka kundërshtuar pretendimet e paraqitura në ankesën e kreditorit, me propozim që ankesa të refuzohet, aktvendimi i atakuar të vërtetohet dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'i paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë në shumën prej 156€ sipas Tarifës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata e Apelit me referim në ankesën e parashtruar dhe në shkresat e lëndës, konstaton se palët në këtë procedurë përmbarimore - kreditori dhe debitori janë shoqëri tregtare, përkatësisht kreditori sh.a (shoqëri aksionare), ndërsa debitori sh.p.k (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar). Në këtë kuptim dhe me referim në dispozitën e nenit 13 paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatën Komerciale ku përcaktohet se “1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”, 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate” dhe paragrafi 2 të po të njëjtit ligj i cili përcakton se “2. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”.

Kështu, nga dispozitat ligjore të cituara si më sipër dhe në ndërlidhje me rrethanat e rastit, kjo gjykatë vjen në përfundim se për vendosje në këtë çështje juridike përmbarimore, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë.

Prandaj, mbi bazën e arsyeve si më lart, lënda bashkë me të gjitha shkresat e saj i dërgohet në kompetencë të mëtejme Gjykatës Komerciale për të vendosur sipas ankesës së Kompanisë Rajonale e mbeturinave “Pastrimi” sh a, Prishtinë, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.506/19, datë 20.05.2019.

Nga të lartcekurat e në bazë të dispozitës së nenit 10, 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 29 dhe 208 të LPK-së dhe nenin 77 dhe 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 3084/22, me datë 20.06.2024

Gjyqtarja
Hunaida Pasuli,